

ZBATIMI I QASJES SË BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË ORGANIZATAT QYTETARE





ZBATIMI I QASJES SË BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË ORGANIZATAT QYTETARE

Shkup, 2020

Metodologjia

ZBATIMI I QASJES SË BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË ORGANIZATAT QYTETARE

Editor:

Instituti për të Drejtat e Njeriut

Autore:

Marina Ivanovska

Redaktore:

Kristina Doda

Recensentë:

Agnes Taibl dhe Katrin Wladasch,
Instituti për të Drejtat e Njeriut “Ludving Bolcman”,
Austri



Ky publikim u hartua me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Ky publikim u hartua me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është në përgjegjësi ekskluzive të Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
QBDNJ NË SIGURIMIN E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE REDUKTIMIN E VARFËRISË.....	9
PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ZBATIMI I QBDNJ NË KRIJIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE?	10
KONTEKSTI – GJENDJA E ZBATIMIT TË QBDNJ NGA ORGANIZATAT QYTETARE NË SHTET.....	11
IMPLEMENTIMI I QBDNJ NË PLANIFIKIMIN E PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE NË ORGANIZATAT QYTETARE.....	11
Aaliza e gjendjes.....	12
Identifikimi i të gjitha palëve të interesuara	13
Iplementimi i projektit/programit.....	14
MONITORIMI DHE EVALUIMI I PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE NË OQ	14
INDIKATORËT E MONITORIMIT	17
BIBLIOGRAFIA	24



Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut në kuptimin metodologjik është kornizë qëllimi i së cilës është përfshirja e të drejtave të njeriut në të gjitha programet, projektet dhe aktivitetet zhvillimore. Kjo qasje theksin e vë mbi realizimin e të drejtave, në vend se mbi kënaqjen e nevojave të grupeve vulnerable në shoqëri.

Metodologjia e Zbatimit të qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut (QBDNj) fillimisht iu dedikua organizatave qytetare. Zbatimi i QBDNj nuk duhet të përfshijë një mënyrë të punës plotësisht të re, por duhet të bazohet në planifikimin sistematik dhe inkluziv dhe në implementimin e projekteve dhe programeve, çdoherë duke e përfshirë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjitha aspektet e punës.

Manuali i zbatimit të qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut, në organizatat qytetare¹, i hartuar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut, bashkë me organizatat partnere, mund të përdoret si një dokument gjithëpërfshirës, bashkë me këtë metodologji.

Gjatë zbatimit të kësaj qasje dhe përdorimit të kësaj metodologjie çdoherë duhet të merret parasysh fakti se QBDNj është një metodë fleksibile dhe në të gjitha programet ose projektet e veçantë, në të cilat do t'i implementoni këto parime, mund të ballafaqoheni me pjesë të cilat janë drejtpërdrejtë të zbatueshme ose me pjesë të cilat janë më pak të zbatueshme. Është me rëndësi çdoherë të keni qasje nga aspekti i respektimit të të drejtave themelore të njeriut, me fokus mbi realizimin e qasjes në drejtësi.

Me përdorimin e kësaj qasje personat nuk janë vetëm përdorues pasiv të shërbimeve, **por janë posedues të të drejtave**, përkatësisht kanë të drejtë të kërkojnë realizim dhe mbrojtje të të drejtave nga **bartësit e detyrimeve**, të cilët e kanë për detyrë ta sigurojnë realizimin e të drejtave.

Ekziston një debat gjithëpërfshirës për dallimet ndërmjet nevojave dhe të drejtave lidhur me atë nëse ndërhyrjet për zhvillim duhet të motivohen nga nevojat ose nga të drejtat e njeriut. Dallimi kryesor konsiston me atë se nevojat nuk nënkuptojnë detyrime ose obligime, edhe pse mund të japin premtime ose mund të nxisin përgjigje të cilat janë në bazë vullnetare. Në kundërshtim me këtë, të drejtat e njeriut çdoherë nënkuptojnë detyrime që kanë të bëjnë me detyrimet e shtetit dhe subjekteve të tij.

¹ Manual për zbatimin e qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut për organizatat qytetare, I aksesshëm në: https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/%D0%9F%D0%A0%D0%98%D0%A0%D0%90%D0%A7%D0%9D%D0%98%D0%9A_%D0%9C%D0%9A%20_.pdf

Qasja humanitare	Qasja e bazuar mbi nevojat	Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut
Njerëzit duhet të pranojnë ndihmë nga ngushëllimi/keqardhja	Njerëzit meritojnë ndihmë	Njerëzit kanë të drejtë për ndihmë
Nuk bazohet në nevojat, dhe as që bazohet në të drejtat, por në nevojën morale të ndihmohet	I përmbush nevojat, por pa inkurajim	E identifikon se të drejtat medoemos duhet të realizohen me inkurajim për përfshirje aktive
Nuk ekzistojnë qëllime, procese dhe rezultate. Vetëm ngushëllim dhe qasje vullnetare.	Qëllimi i fundit është caktuar paraprakisht	Edhe pse qëllimi është përcaktuar paraprakisht, procesi dhe rezultatet janë po ashtu të rëndësishme
Personat perceptohen si viktima	Përmbushja e nevojave perceptohet si qëllim zhvillimor për veten e vet	Personat janë inkurajuar që të përfshihen në proceset dhe ti kërkojnë të drejtat e tyre

QBDNj nuk fokusohet vetëm mbi qëllimet dhe rezultatet e punës, por edhe mbi procesin, si dhe mbi parimet e të drejtave të njeriut të cilat janë inkorporuar në punën e përditshme.

Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut është prezantuar si qasje e cila i integron normat, parimet dhe standardet dhe qëllimet e **sistemit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut**² fnë administrimin dhe zhvillimin.

Standardet e të drejtave të njeriut, si dhe parimet e sanksionuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut³, konventat e OKB-së dhe dokumente të tjerë ndërkombëtarë për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut i vendosën parimet e QBDNj. Këto parime themelore janë: njohja; inkurajimi, pjesëmarrja, sinergjia, mosdiskriminimi dhe barazia; përgjegjësia dhe sundimi i së drejtës; drejtësia sociale si dhe transparenca dhe qasja deri te informacionet. Këto parime mund të aplikohen në të gjitha planifikimet dhe implementimet e projekteve dhe programeve të organizatës, përfshirë këtu edhe monitorimin dhe evaluimin.

QBDNj e përfshin integrimin e ndërgjegjshëm dhe sistematik të të drejtave të njeriut, në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe zbatimit të projekteve dhe programeve,⁴ QBDNj bazohet mbi elementet themelore të cilët e përbëjnë procesin e planifikimit dhe

² Dokumente të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbi të cilat bazohet kjo qasje: Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike; Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas; Konventa Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtitit Brutal, Çnjerëzor, Përçmues ose Ndëshkues; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë; dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

³ Universal Declaration of Human Rights, United Nations General Assembly in Paris on 10 December 1948

⁴ UNFPA A Human Rights – Based Approach to Programing – Practical Implementation Manual and Training Materials, 2014. faq. 70

implementimit të projekteve dhe programeve, por përveç theksimit të procesit, një rëndësi jashtëzakonisht të madhe ka edhe epilogu ose rezultati. Kjo qasje i referohet barazisë dhe mosdiskriminimit, përfshirjes së personave të marginalizuar dhe vulnerabil ose komuniteteve gjatë programimit. Transparenca dhe përgjegjësia janë po ashtu parime të rëndësishme për QBDNj.

Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut i vë njerëzit në qendër të zhvillimit dhe administrimit dhe përpiqet t'i zbuloj problemet kryesore të cilat i pengojnë njerëzit t'i realizojnë të drejtat e tyre.

QBDNj bën një distinkcion të qartë midis personave të drejtat e të cilëve duhet të realizohen dhe subjekteve të cilët kanë detyrim ligjor ta sigurojnë realizimin e të drejtave. Së këtejmi, QBDNj i përcakton poseduesit e të drejtave dhe bartësit e detyrimeve.

Poseduesit e të drejtave (Right holders) janë të gjithë njerëzit, në përputhje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Në qendër të vëmendjes së QBDNj janë personat që u përkasin grupeve të marginalizuara ose vulnerabile të shoqërisë, siç janë gratë nga mjediset rurale, fëmijët, minoritetet etnike, personat me aftësi të kufizuara etj.

Sipas QBDNj, poseduesit e të drejtave kanë të drejtë t'i kërkojnë të drejtat e tyre dhe të kërkojnë përgjegjësi nga bartësit e të drejtave për mosrespektim.

Bartësit e detyrimeve (Duty bearers) janë ata subjekte ose persona të cilët kanë detyrime ose detyra t'i respektojnë, mbrojnë dhe avancojnë të drejtat e njeriut dhe të njëjtat të mos i cenojnë. Nocioni "bartës i detyrimeve" më së shpeshti përdoret për organet e autorizuara shtetërore dhe për organet e tjera në të gjitha nivelet. Shteti është bartësi i fundit i detyrimeve, meqë ai i ratifikon konventat ndërkombëtare. Edhe personat e tjerë, të cilët nuk e përfaqësojnë shtetin, po ashtu mund të jenë bartës të detyrimeve, si për shembull sektori i biznesit.

QBDNJ NË SIGURIMIN E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE REDUKTIMIN E VARFËRISË

QBDNj e identifikon varfërinë si padrejtësi ndërsa marginalizimin, diskriminimin dhe eksploatimin i specifikon si shkaqe kryesore të varfërisë. Sipas QBDNj, varfëria asnjëherë nuk mund të konsiderohet si faj i personit, madje as zgjidhja nuk mund t'i drejtohet individit. Megjithatë, QBDNj varfërinë dhe padrejtësinë nuk i përcakton si nocione abstrakte por potencon se kërkesat për të drejtat e njeriut çdoherë kanë detyrim përkatës. Sipas kësaj, dinamika kryesore e QBDNj konsiston me identifikimin e shkaqeve kryesore të varfërisë, si dhe me atë që t'u mundësohet poseduesve të të drejtave t'i kërkojnë të drejtat e tyre dhe t'u mundësojnë bartësve të detyrimeve t'i përmbushin detyrat e tyre. Në këtë mënyrë QBDNj kujdeset për një numër të madh të karakteristikave kryesore të varfërisë dhe zhvillimit⁵.

⁵ JakobKirkemannBoesen&TomasMartin, Applying a rights-based approach, Danish Institute for Human Rights

të vrazhda të të drejtave të njeriut bëhen përmes akteve të shkarjes. Zhvillimi i pabarabartë dhe neglizhenca ndaj grupeve më të margjinalizuara të shoqërisë perceptohet si shkak kryesor i varfërisë, ndërsa problemi kryesor kërkohet në strukturat e pushtetit dhe në zhvillimin e pabarabartë që janë inkorporuar në kontekstin lokal, nacional dhe global.

Kur do ta kuptojmë se varfëria është komplekse dhe multidimensionale, duhet ta pranojmë nevojën për zgjidhjen e saj me zgjidhje të cilat mund ta përfshijnë këtë kompleksitet. QBDNJ nuk e percepton varfërinë vetëm si mungesë të resurseve të caktuara dhe prandaj rrallëherë mund zgjidhet në mënyrë adekuate, me zgjidhje materiale. Madje edhe atëherë kur resurset janë të aksesshme, qasja deri te të njëjtat shpeshherë iu pamundësohet të varfërve për shkak të asaj se kush janë, ku jetojnë, ose ndonjëherë thjeshtë për shkak të neglizhencës dhe mospasjes së kujdesit. Diskriminimi i këtillë mund të jetë rezultat i normave dhe vlerave sociale të cilat e stimulojnë stigmatizimin dhe margjinalizimin brenda komuniteteve, ose mund të jetë rezultat i diskriminimit të politikave ose të prodhimit të pabarazive juridike, ose të pabarazive sa i përket statusit dhe të drejtave. Nga kjo perspektivë, varfëria është diçka që u shkaktohet njerëzve. Në të vërtetë, mund të pohohet se njerëzit nuk janë të varfër, por bëhen të varfër.

Për këto shkaqe është me rëndësi që gjatë implementimit të programeve/projekteve të cilët e përfshijnë reduktimin e varfërisë, të mos synohet vetëm kënaqja e nevojave momentale, por të kërkohen të drejtat e njerëzve për një jetë dinjitoze jashtë varfërisë.

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ZBATIMI I QBDNJ NË KRIJIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE?

- E promovon realizimin e të drejtave të njeriut dhe u ndihmon bartësve të detyrimeve t'i përmbushin detyrat e tyre për të drejtat e njeriut;
- E rrit dhe fuqizon pjesëmarrjen e bashkësive lokale;
- E përmirëson transparencën;
- I zbaton rezultatet (dhe harmonizohet me administrimin e bazuar në rezultate);
- E rrit përgjegjësinë;
- I redukton dobësitë me fokus mbi më të margjinalizuarit dhe të përjashtuarit në shoqëri;
- Pjesëmarrja e grupeve dhe komuniteteve të margjinalizuara në proceset e miratimit të politikave, veçanërisht ato të cilat i prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë, është element kryesor në një shoqëri demokratike. Kur grupet e margjinalizuara përfshihen në miratimin e vendimeve dhe në zbatimin e politikave, atëherë ato do të mund të ndikojnë në administrimin e gjendjes edhe me pozitën e tyre në shoqëri dhe në këtë mënyrë do ta promovojnë realizimin e zhvillimit të drejtë dhe të qëndrueshëm dhe rregullimin social.

KONTEKSTI – GJENDJA AKTUALE E ZBATIMIT TË QBDNJ NGA ORGANIZATAT QYTETARE NË SHTET

Brenda shtetit ekzistojnë lloje të ndryshme të organizatave qytetare të cilat janë formuar për qëllime të ndryshme, ndërsa synojnë të zgjidhin një varg problemesh. Njëherësh, ekzistojnë edhe organizata me kapacitete të ndryshme dhe me kapital të ndryshëm social me të cilin punojnë.

Në disa fusha të caktuara të veprimit mund të konstatojmë një numër më të madh të organizatave, ndërsa në disa fusha të tjera kemi mungesë të tyre. Megjithatë, me aktivitetet e tyre, gjatë viteve të kaluara organizatat qytetare në shtet manifestuan gatishmëri dhe përgatitje për të bërë shumë ndryshime në shoqëri.

Hulumtimi⁶ i IDNj, tregoi se, edhe pse shumica e organizatave nuk janë të njoftuara me QBDNJ, megjithatë, gjatë planifikimit dhe implementimit të programeve dhe projekteve pjesa më e madhe e tyre i kanë përfshirë parimet themelore të QBDNJ. Nga ana tjetër, shqetëson fakti se vetëm një pjesë e vogël e tyre e zbatojnë monitorimin dhe evaluimin e programeve/projekteve. Një vëmendje e veçantë duhet t'i përkushtohet promovimit të Qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut në organizatat të cilat punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me grupet e qytetarëve të marginalizuar.

IMPLEMENTIMI I QBDNJ NË PLANIFIKIMIN E PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE TË ORGANIZATAVE QYTETARE

Organizatat qytetare më së shpeshti punën e tyre e organizojnë në kuadër të projekteve (në periudhë paraprakisht të caktuar kohore) ose të programeve afatgjata të cilat më së shpeshti përfshijnë procese afatgjata të monitorimit të punës së institucioneve, hulumtime ose ofrim të shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët.

Pavarësisht asaj se çfarë lloji të aktiviteteve zbaton organizata qytetare, ose çfarë mënyre të punës praktikon, më së shpeshti përdoret koncepti **“projekt”** ose **“program”** gjatë implementimit të aktiviteteve. Për këtë shkak, kjo metodologji, para së gjithash, fokusohet në zbatimin e QBDNJ në kuadër të ciklit të projektit.

Projekti nënkupton një varg aktiviteteve të cilat bashkërisht fokusohen në arritjen e qëllimit të përcaktuar të qartë në kuadër të kohës paraprakisht të caktuar dhe me buxhet të përcaktuar.⁷

Cikli i projektit e monitoron rrjedhën e projektit, nga ideja fillestare, identifikimi i problemit dhe palët e interesuara, deri në dizajnin e aktiviteteve dhe mjeteve, përmes

⁶ Pyetësori iu dërgua 200 OQ, ndërsa përgjigje u pranuan nga 19 organizata.

⁷ https://ec.europa.eu/international-partnerships/funding/managing-project_en

zbatimit, deri në monitorimin dhe evaluimin e tij. Në këtë pjesë do të përqendrohemi në proceset më të rëndësishme të ciklit të projektit, në të cilat është i domosdoshëm zbatimi i QBDNJ, siç është **analiza e gjendjes, identifikimi i palëve të interesuara, si dhe monitorimi dhe evaluimi**.

Nevojitet një kujdes sistematik dhe i ndërgjegjshëm për të drejtat e njeriut në të gjitha aspektet e implementimit të ciklit të projektit.

Analiza e gjendjes

Pas identifikimit të problemit, **analiza e gjendjes** është hapi i parë në ciklin e zakonshëm të projektit. Në këtë pjesë duhet të identifikohet situata momentale dhe rrethanat relevante të fushës të cilës i referohet problemi.

Planifikimi i projektit fillon me identifikimin e problemit i cili duhet të adresohet nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe të konstatohet cilat janë shkaqet kryesore të cilat kanë çuar në ekzistimin e një problemi të këtillë. Në këtë fazë detektohet se kush është i prekur nga problemi, në ç'mënyrë është prekur, si është situata dhe cili është ndikimi i problemit mbi palët e prekura.

Gjatë analizës së gjendjes realizohet edhe një analizë gjithëpërfshirëse e shkaqeve dhe problemeve shoqërore, institucionale dhe strukturore, pastaj konstatohen normat shoqërore dhe kapacitetet institucionale në të gjitha nivelet e pushtetit, mekanizmat në dispozicion për kërkim të përgjegjshëm, si dhe korniza juridike e problemit.⁸ Të gjithë këta faktorë mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht mbi realizimin e të drejtave të grupeve vulnerable. Së këtejmi, është shumë e rëndësishme që këto aspekte të identifikohen në mënyrë të qartë. Është po aq e rëndësishme të jepet përgjigje në pyetjen kryesore “Pse ekziston problemi i caktuar?... dhe Cilat janë shkaqet kryesore për ekzistimin e tij?”

Një pjesë e rëndësishme e proceseve të planifikimit dhe formulimit të projekteve është zgjedhja e strategjisë se si të adresohet një problem i caktuar. Qëllimi i këtij hapi është identifikimi i aktiviteteve potenciale për të cilat mbase mund të kontribuojnë në reduktimin e dallimeve të kapaciteteve midis poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrimeve. Aktivitetet e këtilla duhet të fokusohen në rritjen e përgjegjshëm, autoritetit, resurseve dhe proceseve të vendimmarrjes dhe aftësive të komunikimit të poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrimeve, duke i marr parasysh shkaqet themelore/ strukturore të problemit të identifikuar.⁹

⁸ Manual për zbatimin e të drejtave të Njeriut, Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe organizata të tjera, 2019, I aksesshëm në: https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/%D0%9F%D0%A0%D0%98%D0%A0%D0%90%D0%A7%D0%9D%D0%98%D0%9A_%D0%9C%D0%9A%20_.pdf

⁹ Ibid.

Identifikimi i të gjitha palëve të interesuara

Procesi i dizajnit dhe implementimit të një programi ose projekti të caktuar kërkon identifikim të qartë të pozitës, rolit dhe përvojave të çdo faktori, përkatësisht të çdo pale të interesuar.

Pyetjet kryesore të cilat duhet të parashtrihen janë: Cilët janë poseduesit e mundshëm të të drejtave për problemin konkret? dhe Cilët janë bartësit e mundshëm të detyrimeve?

Gjatë përpilimit të analizës së palëve të interesuara dhe faktorëve, e cila është përfshirë në procesin e planifikimit të projektit ose programit, duhet të merren parasysh më shumë aspekte, dhe veçanërisht atë se në cilën mënyrë projekti mund të ndikoj mbi grupin ose rëndësinë e çdo faktori për projektin/programin konkret.

Palë të interesuara janë persona, grupe ose institucione me interes për projektin ose me mundësi të ndikojnë mbi rezultatet, pozitivisht ose negativisht. Palët e interesuara mund të preken në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Shtrirja e palëve potencialisht të interesuara është e ndryshme dhe mund të përfshijë grupe të synuara të përdoruesve (më së shpeshti grupe specifike të personave, si për shembull, persona me aftësi të kufizuara, minoritete etnike, fëmijë, LGBTI etj.), komunitete ose individë të interesuar lokal, autoritete nacionale ose lokale, organizata qytetare (vendore dhe në momente të caktuara ndërkombëtare) politikanë, komuniteti akademik, subjekte nga sektori privat, organizata të punës etj.

Analiza e palëve të interesuara është një proces i identifikimit të faktorëve kryesorë të projektit, vlerësimit të interesave të tyre dhe mënyrat në të cilat palët e interesuara mund të ndikojnë në rezultatet e projektit. Duhet të identifikohen raportet e fuqisë dhe aleancat dhe konfliktet potenciale midis palëve të interesuara. Analiza e palëve të interesuara e siguron bazën e planifikimit të angazhimit të palëve të interesuara gjatë gjithë ciklit të projektit. Angazhimi i palëve të interesuara është një termin gjithëpërfshirës i cili përfshinë një sërë aktivitete dhe interaksionesh me palët e interesuara gjatë gjithë ciklit të projektit.

Angazhimi i palëve të interesuara e mbështet zhvillimin e lidhjeve të forta, konstruktive dhe të përgjegjshme të cilat janë kyç për dizajnin e shëndetshëm dhe implementimin e projektit. Përfshirja efektive e palëve të interesuara e përmirëson pranimin dhe ndjenjën e pronësisë mbi projektin, ndërsa me këtë rritet edhe qëndrueshmëria e rezultateve.

Udhëzime për pjesëmarrjen e palëve të interesuara gjatë vendimmarrjes në kuadër të ciklit të projektit



Gjatë identifikimit të palëve të interesuara është mjaft e rëndësishme të përpilohet Analiza gjinore – sensitive, me qëllim që të identifikohen politikat gjinore-sensitive të përfshirjes, ndërsa të shmangët disbalanci gjinor gjatë vendimmarrjes. Analiza gjinore duhet të siguroj edhe të dhëna për numrin e burrave dhe grave të cilët potencialisht janë të prekur nga projekti. Është mjaft e rëndësishme që gjatë analizës gjinore të merret parasysh edhe aspekti interseksional, veçanërisht duke i pasur parasysh gratë nga mjediset rurale, gratë të cilat u përkasin bashkësive minoritare, gratë me aftësi të kufizuara dhe ngjashëm.¹⁰

Implementimi i projektit/programit

Implementimi është fazë në të cilën çdo gjë që është planifikuar në fazën e planifikimit fillon të implementohet.

Implementimi i projekteve, me zbatimin e QBDNj, dallohet nga implementimi pa QBDNj:

- Gjatë implementimit të projekteve në të cilat zbatohet QBDNj, detyrimisht përfshihen poseduesit e të drejtave dhe bartësit e detyrimeve;
- Strategjia e implementimit të projekteve fokusohet mbi fuqizimin e poseduesve të të drejtave;
- Strategjia e implementimit të projekteve fokusohet edhe mbi fuqizimin e përgjegjësisë të bartësve të detyrimeve, në mënyrë që t'i përmbushin detyrat e tyre ndaj poseduesve të të drejtave;
- Gjatë implementimit të projekteve në të cilat zbatohet QBDNj detyrimisht respektohen parimet e të drejtave të njeriut;
- Strategjia krijon rezultate të qëndrueshme të cilat sjellin ndryshime të thella në shoqëri, meqë kryesisht fokusohen në probleme të thella siç është padrejtësia, pabarazia, diskriminimi dhe mosnjohja e të drejtave.

MONITORIMI DHE EVALUIMI I PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE NË OQ

Monitorimi dhe evaluimi janë elementë thelbësor të çdo projekti të cilët kanë për qëllim ta përcaktojnë shkallën e përmbushjes së qëllimeve në kuadër të kohëzgjatjes së projektit, si dhe pas përfundimit të tij. Në bazë të tyre përpilohet raport i qartë dhe i saktë për rezultatet e arritura. Nga ana tjetër, ato ofrojnë mundësi për analizën e punës, në lidhje me mësimin e organizuar dhe informimin e vendimmarrjes.

Monitorimi dhe evaluimi e përfshijnë mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rezultateve reale të projektit, në krahasim me disa projekte të planifikuara ose të pritshme.

Monitorimi nënkupton grumbullim të organizuar dhe të vazhdueshëm, analizë dhe përdorim të të dhënave gjatë kohës së projektit/programit me qëllim të mbikëqyrjes së progresit.

¹⁰ Guidance Note UNDP, Social and Environmental Standards (SES), Stakeholder Engagement, UNDP 2017, I aksesshëm në: https://info.undp.org/sites/bpps/SES_Toolkit/SES%20Document%20Library/Final%20UNDP%20SES%20Stakeholder%20Engagement%20GN_Oct2017.pdf

Evaluimi është vlerësim periodik dhe retrospektiv i efikasitetit, efektivitetit, ndikimit, qëndrueshmërisë dhe relevancës së një projekti të caktuar, në kontekstin e qëllimeve të përcaktuara. Zakonisht ai realizohet si vlerësim i pavarur, me qëllim të identifikimit të gjetjeve mbi të cilat do të mbështeten vendimet e ardhshme. Evaluimi përdoret për matjen dhe vlerësimin e ndikimit afatgjatë të projektit.¹¹

Dallimi kryesor midis monitorimit të projekteve me ose pa QBDNj konsiston me atë që tek projektet me QBDNj përveç matjes së produkteve, epilogut dhe ndikimit, detyrimisht maten edhe proceset.

Mbikëqyrja dhe evaluimi janë mënyrë e rëndësishme që të sigurohemi se projektet i implementojmë sipas planit dhe t'i arrijmë rezultatet e dëshiruara. Së këtëjmi, QBDNj një theks të veçantë vë mbi monitorimin dhe evaluimin. Gjatë QBDNj është me rëndësi jo vetëm të mbikëqyren dhe të vlerësohen rezultatet, por edhe procesi me të cilin arrihen. Parimi themelor i QBDNj konsiston me atë se proceset e zhvillimit duhet të bazohen mbi parimet e të drejtave të njeriut dhe së këtëjmi vazhdimisht duhet të sigurojmë se proceset e projektit janë të përgjegjshme, participative dhe jodiskriminuese. Gjatë monitorimit të proceseve, është me rëndësi të vërehet se projektet/programet nuk duhet të shkaktojnë kurrfarë dëmi mbi të drejtat e njeriut. Në përpjekjen që të përmirësohet një e drejtë e njeriut duhet të jemi të sigurt se nuk do të cenojmë të drejta të tjera të njeriut. Nëse paraqitet ndonjë dyshim ose indikacion se projekti ka efekt negativ, atëherë duhet menjëherë të shqyrtohet dhe të shmanget. Veç tjerash, duhet të sigurohemi se parimet e të drejtave të njeriut janë pjesë përbërëse të punës së përgjithshme të organizatës.

Është më se e nevojshme në mënyrë të veçantë të monitorohet diskriminimi i mundshëm transparent ose i kamufluar i mënyrës së implementimit të projekteve. Disa praktika të caktuara, të cilat aplikohen gjatë implementimit të projekteve, mund të kenë ndikim negativ mbi të drejtat e një grupi të caktuar të njerëzve ose të jenë diskriminuese.

Një element i rëndësishëm, kur monitorohet diskriminimi është përdorimi i të dhënave mjaftueshëm të ndara, përkatësisht, i të dhënave të segreguara. Ndoshta analiza fillestare do të konkludojë se gratë nuk janë të diskriminuara, por gjatë përcaktimit më të detajuar të ndikimit mund të shihet se gratë nga mjediset rurale dhe gratë të cilat u përkasin minoriteteve të caktuara në masë të konsiderueshme janë të përjashtuara nga proceset. Monitorimi duhet të jetë i rregullt dhe madje do të ishte ideale të përfshijë mekanizma për informacione kthyesë me të cilat do të mundësohej mbikëqyrja dhe njohja e mirëfilltë participative e statusit të palëve të interesuara, si posedues të të drejtave. Një element i rëndësishëm i mekanizmave për vendosjen e informacioneve kthyesë është se poseduesit e të drejtave janë të vetëdijshëm për qëllimet, për rezultatet e planifikuara, si dhe për të gjitha standardet në bazë të të cilave implementohet projekti.

¹¹ A step by step guide to monitoring and evaluation, 2014; ctp.5. I aksesshëm në: <https://transitionnetwork.org/wp-content/uploads/2016/09/Monitoring-and-evaluation-guide.pdf>

Zbatimi i QBDNj gjatë monitorimit:

- Plani i monitorimit me data, afate dhe raportim i cili fokusohet në monitorimin e asaj që është implementuar dhe realizuar në kuadër të qëllimeve të projektit, por të bazuara mbi QBDNj;
- Indikatorë të matshëm;
- Mekanizëm për mbikëqyrje i cili e përfshin përfshirjen e plotë të palëve të interesuara dhe pjesëmarrjen në proceset;
- Procesi i mbikëqyrjes i cili rreptësishtë u përmbahet parimeve të QBDNj.
- Programi për zhvillimin e kapacitetit i cili do të siguroj të gjitha palët e interesuara / bartësit e detyrimeve të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe efiziente.
- Mekanizmi për mbikëqyrje mbi autoritetin, kapacitetin dhe resurset përkatëse.
- Rezultatet e procesit të mbikëqyrjes janë transparente dhe të aksesshme.

Zbatimi i QBDNj gjatë evaluimit

Gjatë evaluimit të bazuar në QBDNj vlerësohet puna e planit lidhur me të drejtat e njeriut, ndikimi i planit lidhur me ndryshimet e cilësisë së jetës së njerëzve dhe bëhet krahasimi i implementimit me standardet, normat dhe parimet e vendosura të të drejtave të njeriut.

Të drejtat e njeriut kërkojnë sistem monitorimi dhe evaluimi, i cili është:

- Participativ dhe inkluziv;
- Transparent;
- I përgjegjshëm.

Disa nga pyetjet e parashtruara kryesore të proceseve të monitorimit dhe evaluimit:

- A ka krijuar ose a ka shkaktuar projekti kushte të nevojshme për realizimin e të drejtave të njeriut?
- A realizohen prioritetet buxhetore në favor të qytetarëve më të rrezikuar?
- Njëherësh, e vlerëson ndikimin e planit, në lidhje me ndryshimet e cilësisë së jetës të njerëzve:
- A ka rezultuar projekti me ndryshime të cilësisë së jetës, në përputhje me dinjitetin e njeriut?
- A i gëzojnë njerëzit të drejtat e tyre të njeriut, si rezultat i projektit?
- A i realizojnë dhe kërkojnë njerëzit me përgjegjësi të drejtat e tyre?
- I shqyrton edhe supozimet themelore të ndërhyrjes lidhur me standardet e të drejtave të njeriut, normat dhe parimet:
- A ndërlihet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërhyrja me të drejtat e njeriut?
- A rezulton ndërhyrja në rezultate të mirëfillta të cilat janë në dobi të grupeve të marginalizuara në shoqëri?
- A përfshin ndërhyrja strategji të kompletuara, të integruara dhe të orientuara për fuqizim, përfshirje dhe barazi?



INDIKATORËT E MONITORIMIT

Në këtë pjesë janë prezantuar indikatorët e përgjithshëm të cilët duhet të monitorohen gjatë fazave kryesore të ciklit të projektit.

Ekziston dallim metodologjik midis indikatorëve të të drejtave të njeriut dhe indikatorëve për matjen e zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.¹²

Përfshirja e parimeve të të drejtave të njeriut në planifikimin, implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve e përfshinë edhe përdorimin e indikatorëve për vlerësimin e shkallës deri te e cila vet projekti/programi e reflekton përkushtimin e plotë të standardeve dhe principeve të të drejtave të njeriut. Vendimet e miratuara gjatë analizës së situatës dhe implementimit të projektit / programit, si dhe institucionalizimi i procedurave për vendimmarrje, duhet të reflektojnë me përkushtim të drejtpërdrejtë mbi standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut¹³

Indikatorët e prezantuar në këtë tabelë, janë në drejtim të qëllimeve të specifikuara dhe janë parime të përgjithshme që duhet të arrihen. Indikatorët dhe targetët specifik duhet të përcaktohen për çdo projekt/program të ndryshëm.

Indikator – i përgjithshëm	Indikatorë plotësues të matshëm varësisht nga fusha
Planifikimi i projekteve dhe programeve	
Analiza e problemit/gjendjes	
OQ implementon proces të detajuar për përcaktimin e gjendjes, bazuar në QBDNj	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
Projekti ka qëllime të specifikuara të qarta, të bazuara në QBDNj	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 

¹² Human Rights Indicators, A Guide to measurement and Implementation, United Nations Human Rights Office, New York and Geneva, 2012

¹³ Ibid.

Indikator – i përgjithshëm**Indikatorë plotësues të matshëm
varësisht nga fusha****Planifikimi i projekteve dhe programeve**

Janë identifikuar cenimet e të drejtave të njeriut dhe është bërë analizë nëse cenimet e të drejtave të njeriut janë mbrojtur me kornizën ligjore nacionale dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut




Gjatë analizës së problemit/gjendjes, një vëmendje e veçantë i është përkushtuar analizës së diskriminimit dhe pabarazisë




Janë identifikuar bartësit kryesorë të detyrimeve për përmbushjen e detyrave të respektimit të të drejtave të njeriut



Janë identifikuar marrëdhëniet më të rëndësishme të cilat i prekin të drejtat e njeriut midis poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrimeve



Janë identifikuar kërkesat që i kanë poseduesit e të drejtave, si dhe detyrat përkatëse të bartësve të detyrimeve



Indikator – i përgjithshëm	Indikatorë plotësues të matshëm varësisht nga fusha
Planifikimi i projekteve dhe programeve	
<p>Janë identifikuar mangësitë më të rëndësishme të kapaciteteve të poseduesve të të drejtave të cilat i kufizojnë nga e drejta që të kërkojnë realizim dhe mbrojtje të të drejtave të tyre dhe mangësitë më të rëndësishme të kapaciteteve të bartësve të detyrimeve, që t'i përmbushin detyrat e tyre në lidhje me poseduesit e të drejtave</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>Janë identifikuar detyrat konkrete të cilat bartësit e detyrimeve duhet t'i ndër marrin me qëllim të respektimit, mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të poseduesve të të drejtave</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>Gjatë gjithë procesit të planifikimit janë përfshirë qëndrimet e grupeve vulnerabile ose të marginalizuara dhe të grupeve të ekspozuara në rrezik nga diskriminimi</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>Janë identifikuar ndikimet e mundshme kryesore pozitive dhe negative të projektit/programit mbi të drejtat e tjera të njeriut</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>Projekti/programi i adreson shkaqet e cenimit të të drejtave të njeriut (strukturore, kulturore dhe ngjashëm</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 

Indikator – i përgjithshëm	Indikatorë plotësues të matshëm varësisht nga fusha
Planifikimi i projekteve dhe programeve	
<p>Programet/projektet përfshijnë standarde për të drejtat e njeriut dhe i marrin parasysh projektet e autoriteteve të Kombeve të Bashkuara</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
Identifikimi i palëve të interesuara	
<p>Në procesin e kontrollit paraprak në mënyrë të drejtpërdrejt janë konsultuar dhe përfshirë grupet e synuara, si pjesëmarrës aktivë</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>Janë siguruar një sërë procese të cilët e lehtësojnë dhe stimulojnë pjesëmarrjen (për shembull, onlajn konsultime, tubime publike në vende lehtësisht të arritshme, veçanërisht për grupet vulnerabile, takime etj.</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>Në procesin e identifikimit konsultohen faktorë të ndryshëm shoqëror (ministri relevante, organizata të tjera qytetare, Ombudsmeni, trupa dhe komisione të pavarura, relevante për problemin etj.)</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>U përcaktuan mekanizma për përfshirjen e poseduesve të të drejtave gjatë gjithë procesit</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 

Indikator – i përgjithshëm**Indikatorë plotësues të matshëm
varësisht nga fusha****Planifikimi i projekteve dhe programeve**


Promovohet mësimi dhe bashkëpunimi midis palëve të interesuara

**Implementimi i projektit/programit**


Gjatë implementimit/zbatimit të aktiviteteve mbahet llogari për respektimin e QBDNj dhe shmangët çdo ndikim i mundshëm negativ, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi ndonjë të drejtë të caktuar




Gjatë implementimit të çdo aktiviteti me kujdes merret parasysh obligimi për respektimin e të gjitha parimeve të të drejtave të njeriut










Aktivitetet përfshijnë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave dhe e miratojnë perspektivën gjinore gjatë gjithë procesit.



Mbahet llogari, nëse është e mundur, resurset materiale të nevojshme për implementim të furnizohen nga furnizues të cilët i respektojnë të drejtat e njeriut



Indikator – i përgjithshëm	Indikatorë plotësues të matshëm varësisht nga fusha
Planifikimi i projekteve dhe programeve	
Monitorimi dhe evaluimi	
Janë vendosur indikatorë për monitorim dhe evaluim të cilët janë të matshëm	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
Palët e interesuara aktivisht janë të përfshira në proceset e monitorimit dhe evaluimit	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
Ekziston mekanizëm për pranimin e informacioneve kthyese nga palët e interesuara gjatë gjithë implementimit të projektit/programit	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
Gjatë implementimit zbatohen parimet e të drejtave të njeriut, siç është pjesëmarrja, transparenca dhe inkluzioni	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
Të dhënat, aty ku një gjë e këtillë është e mundshme, grumbullohen në mënyrë të ndarë sipas gjinisë, përkatësisë etnike, mjedisit rural dhe urban, statusit social, orientimit seksual dhe identitetit gjinor	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 

Indikator – i përgjithshëm	Indikatorë plotësues të matshëm varësisht nga fusha
Planifikimi i projekteve dhe programeve	
<p>Informacionet që identifikojnë individë të caktuar ose zbulojnë karakteristika personale të individëve, nuk duhet të publikohen publikisht, si rezultat i grumbullimit të të dhënave (Ndarja e të dhënave duhet të bëhet sipas procedurave paraprakisht të përcaktuara për mbrojtjen e të dhënave)</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 
<p>Ekziston plani i rrezikut, i cili do të zbatohet nëse shfaqet ndonjë veprim i caktuar i cili mund të ndikoj negativisht mbi persona ose grupe të caktuara</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> 

BIBLIOGRAFIA:

- Guidance Note UNDP, Social and Environmental Standards (SES), Stakeholder Engagement, UNDP 2017, aksesshëm në:
https://info.undp.org/sites/bpps/SES_Toolkit/SES%20Document%20Library/Final%20UNDP%20SES%20Stakeholder%20Engagement%20GN_Oct2017.pdf
- Project Cycle Management Guidelines- Volume 1, European Commission, EuropeAid Cooperation Office, 2004, Available at:
<https://iwlearn.net/resolveuid/6044b286-0674-40db-9043-a947532161cd>
- The United Nations, Universal Declaration of Human Rights, 1948
- UNFPA A Human Rights – Based Approach to Programing – Practical Implementation Manual and Training Materials, 2014
- Universal Declaration of Human Rights, United Nations General Assembly in Paris on 10 December 194
- JakobKirkemannBoesen&TomasMartin, Applying a rights-based approach, Danish Institute for Human Rights
- Human Rights Indicators, A Guide to measurement and Implementation, United Nations Human Rights Office, New York and Geneva, 2012
- Manual për zbatimin e qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut, Informacione dhe udhëzime për integrimin e qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut në punën e organizatave qytetare në RM, Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2019

